

VENDIM
Nr. 66, datë 15.9.2016

PËR PLANIN E DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE “PËR KRIJIMIN E FONDIT SHQIPTAR TË KONKURRUESHMËRISË PËR PERIUDHËN 2016–2018”

Komisioni i Ndihmës Shtetërore me pjesëmarrjen e:

- | | |
|-----------------------|----------|
| - Znj. Milva Ekonomi | kryetar; |
| - Znj. Mimoza Dhëmbi | anëtar; |
| - Z. Ahmet Maqcellari | anëtar; |
| - Z. Petrit Bakiu | anëtar; |
| - Z. Gramoz Hoxha | anëtar. |

Në mbledhjen e tij të radhës të datës 15.9.2016, nëpërmjet Drejtorisë së Tregut të Brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), në bazë të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit”, morri në shqyrtim “Planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë për periudhën 2016–2018””.

I. Procedura

1. Njoftimi i skemës është bërë pranë Drejtorisë së Tregut të Brendshëm nga Drejtoria e Mbështetjes së Sipërmarrjes në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS).

II. Përshkrimi i skemës së ndihmës shtetërore

2. Konteksti: Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, në cilësinë e dhënësit të ndihmës shtetërore, dhe përgjegjës për hartimin e politikave ekonomike e tregtare në mbështetje të biznesit, me qëllim krijimin e kushteve lehtësuese dhe faciliteteve në rritjen e prodhimit dhe punësimit duke krijuar kështu bazat për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të vendit ka marrë nismën për krijimin e skemës së ndihmës “Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë për periudhën 2016–2018”. Kjo skemë ndihme është në zbatim të Programit Strategjik të Qeverisë për të mbështetur fuqizimin e kompanive shqiptare me synim promovimin e produkteve “Made in Albania” globalisht, rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare, rritjen e punësimit, dhe përmirësimin në vazhdimësi të bilancit tregtar.

3. Kjo skemë ndihme vjen si rezultat i mbylljes në fund të vitit 2015 të Fondit ekzistues të Konkurrueshmërisë. Fondi i konkurrueshmërisë ka 9 vjet që është në shërbim të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke asistuar ato nëpërmjet një skeme grant bazuar në ndarjen e kostove. Kjo mbështetje financiare ka ndikuar për të rritur konkurrueshmërinë e tyre në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Në këtë kontekst, vendimi i KNSH-së nr. 10, datë 2.2.2007, “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për grantin “Për krijimin e fondit shqiptar të Konkurrueshmërisë””, me anë të cilit është miratuar kjo skemë ka pushuar fuqinë juridike.

4. Objektivi: Skema e ndihmës ka si objektivi rritjen e aftësisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, për të konkurruar në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare, nëpërmjet rritjes së cilësisë së prodhimit e menaxhimit, integritit të tyre dhe nxjerrjes së produkteve që të përmbushin kërkesat e standardeve të këtij tregu.

5. Baza ligjore: Baza ligjore për dhënien e ndihmës është:

a) Neni 6, shkronjat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”, dhe neni 7, të ligjit nr. 8957, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar.

b) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 24, datë 20.1.2016 “Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë”.

6. Buxheti dhe mënyra e financimit: Fondit Shqiptar i Konkurrueshmërisë ka një vlerë të përgjithshme prej 84 000 000 (tetëdhjetë e katër milionë) lekë, për periudhën 2016–2018. Vlera e fondit për secilin vit do të jetë 28 000 000 (njëzet e tetë milionë) lekë. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i kësaj skeme, do të përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për ekonominë, e cila

krijon një zë të veçantë për këtë qëllim, për llogari të AIDA-s. Pagesa e subvencionit do të bëhet 50% me miratimin e projektit dhe 50% në fund të zbatimit të tij. Pagesa në fund të projektit do të bëhet kundrejt faturave të shpenzimeve të kryera për vlerën totale të projektit.

7. Intensiteti i ndihmës: Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë u jep ndihmë financiare të drejtpërdrejtë ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme deri në 70% të kostove të pranueshme por në asnjë rast jo më shumë se 1 400 000 (një milion e katërqind mijë) lekë. Në kostot e pranueshme që mund të bashkëfinancohen, përfshihen kostot, për:

- a) përshtatje produkti, përfshirë ambalazhimin dhe etiketimin, certifikim produkti, vlerësim konformiteti dhe zbatim të sistemeve të menaxhimit të cilësisë;
- b) pjesëmarrje në panaire jashtë vendit;
- c) krijim faqeje interneti, zhvillim të tregtisë elektronike dhe promovim, publikim dhe hartim materiale promovuese.

8. Kohëzgjatja: Skema parashikohet të fillojë zbatimin në vitin 2016 dhe të zgjasë për një periudhë 3-vjeçare, deri në vitin 2018.

9. Përfituesit: Përfitojnë nga Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) prodhojnë në Shqipëri produkte dhe/apo ofrojnë shërbime, të cilat tregtohen brenda dhe/apo jashtë vendit;
- b) kanë selinë e tyre brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;
- c) kanë një strategji dhe plan marketingu;
- d) janë në gjendje të financojnë 100 për qind të gjitha kostot e projektit, të propozuara para përfundimit të tij;
- e) kanë paguar të gjitha detyrimet e parashikuara nga legjislacioni tatimor dhe doganor.

III. Vlerësimi i ekzistencës së ndihmës shtetërore

10. Vlerësimi i kriterëve që përcaktojnë nëse një masë përbën ndihmë shtetërore do të bëhet bazuar në ligjin nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, si dhe në praktikën administrative të Komisionit Evropian, jurisprudencën e gjykatave të Bashkimit Evropian, sipas parashikime dhe detyrimit që buron nga nenin 71 “Konkurrenca dhe dispozita të tjera ekonomike”, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Komuniteteve Evropiane e Shteteve të Tyre Anëtare dhe Republikës së Shqipërisë:

“2. Praktikën në kundërshtim me këtë nen vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i rregullave të konkurrencës të aplikueshme në Komunitet, sidomos në nenet 81, 82, 86 dhe 87 të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian dhe instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit.”.

11. Në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, një masë përbën ndihmë shtetërore, nëse përmbushen, në mënyrë kumulative, këto kushte:

- a) aktivizohen burime shtetërore;
- b) përfituesit i jepet një avantazh ekonomik në mënyrë selektive; dhe
- c) shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën;
- d) ka ndikim në tregti.

“Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë ligj, ndalohej çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdo lloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara.”.

Burimet shtetërore

12. Komisioni i Ndihmës Shtetërore konstaton se skema financohet direkt nga buxheti i shtetit shqiptar (pika 8 e VKM-së nr. 24, datë 20.1.2016, “Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë”) dhe rrjedhimisht, aktivizohen burime shtetërore.

Avantazhi ekonomik dhe selektiviteti

13. Skema e ndihmës ka karakter selektiv, sepse prej saj përfitojnë vetëm një numër i kufizuar ndërmarrjesh mikro, të vogla dhe të mesme, që plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 3 të VKM-së

nr. 24/2016. Rrjedhimisht, jo të gjitha ndërmarrjet që operojnë në treg kanë aftësinë për të aplikuar dhe përfituar nga mbështetja financiare. Procedurat e aplikimit dhe kriteret për përzgjedhjen e përfituesve përcaktohen në rregulloren e funksionimit të Fondit Shqiptar të Konkurruesh-mërisë, e cila miratohet nga ministri përgjegjës për ekonominë. Ndërmarrjet përfituese kanë avantazh ekonomik, kundrejt atyre ndërmarrjeve të tjera, pasi ato marrin nga shteti një ndihmë financiare, që në kushte normale të zhvillimit të veprimtarisë së tyre nuk siguronin.

Shtrembërimi i konkurrencës dhe efekti në tregti

14. Masa e ndihmës ka potencial për të ndikuar në konkurrencë dhe në tregti, duke qenë se forcon pozitën ekonomike të ndërmarrjeve fituese kundrejt ndërmarrjeve të tjera që operojnë në të njëjtin treg.

Konkluzion

15. Sa më sipër, duke qenë se skema u jep ndërmarrjeve përfituese një avantazh ekonomik selektiv, financohet direkt nga buxheti i shtetit, ka efekt në konkurrencë dhe tregti, Komisioni vlerëson se masa përbën ndihmë shtetërore.

IV. Vlerësimi i përputhshmërisë së skemës

16. Neni 8 i ligjit nr. 9374/2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, parashikon se:

“1. Ndihma “*De minimis*” është e lejueshme nëse, pavarësisht nga forma ose qëllimi për të cilin i jepet një ndërmarrjeje, nuk kalon vlerën maksimale për një aktivitet të caktuar, për një periudhë financiare prej tre vjetësh.”

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 605, datë 31.8.2016, “Për përcaktimin e vlerës maksimale, të kushteve dhe të procedurës për dhënien e ndihmës “*De minimis*” përcakton vlerën maksimale të lejuar, si dhe kushtet për autorizimin e ndihmës “*De minimis*”.

Kreu II i vendimit të KM-së parashikon:

1. Ndihma lejohet nëse përmbushen njëherësh kushtet e mëposhtme:

a) Vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje të vetme nuk i kalon 14.000.000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh, e llogaritur në përputhje me kushtet dhe parimet e parashtruara në kreun 3 të këtij vendimi;

b) Ndihma është transparente, nëse ekuivalenti bruto i grantit (EBG) mund të llogaritet me saktësi para dhënies së ndihmës, pa pasur nevojë të kryhet një vlerësim risku për konkurrencën, në përputhje me kërkesat dhe parimet e parashtruara në kreun 4 të këtij vendimi.

Kreu III “Llogaritja e ekuivalentit bruto të grantit”

“1. Granti dhe subvencioni në të holla janë ndihmë transparente”

Sa më sipër bazuar në ligjin “Për ndihmën shtetërore” dhe vendimin e KM-së nr. 605/2016, ndihma “*De minimis*” lejohet, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:

a) Vlera totale e ndihmës dhënë një ndërmarrjeje nuk i kalon 14.000.000 (katërmëdhjetë milion) lekë, për një periudhë financiare prej tre vjetësh. Ky kusht plotësohet, pasi masa konsiston në dhënien e ndihmës financiare të drejtpërdrejtë ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme, në asnjë rast kjo ndihmë nuk mund të kalojë shumën e 1.400.000 (një milion e katërqind mijë) lekë për ndërmarrje.

b) Ndihma duhet të jepet për një periudhë financiare prej tre vjetësh.

Kohëzgjatja e të gjithë skemës, e cila është marrë në shqyrtim, është 3 vjet, duke plotësuar dhe kushtin tjetër ligjor.

c) Ndihma është transparente, granti dhe subsida në të holla janë ndihmë transparente¹. Në rastin konkret, ndihma jepet në formën e grantit.

17. Sa më lart, Komisioni i Ndihmës Shtetërore vlerëson se skema e ndihmës shtetërore është në përputhje me nenin 8, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndihmës Shtetërore, në bazë të nenit 4, 8, 17, 22 dhe 31, të ligjit nr. 9374, datë

¹ Neni 4, COMMISSION REGULATION (EU) No 1407/2013

21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar:

VENDOSI:

1. Të miratojë skemën e dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e Fondit Shqiptar të Konkurrueshmërisë për periudhën 2016–2018”, si një skemë ndihme të lejueshme.
2. Çdo plan ndihme, i cili ndryshon masën e ndihmës, lidhur me vlerën, kohëzgjatjen ose kriteret duhet të njoftohet dhe të marrë miratimin e KNSH-së.
3. AIDA, brenda datës 31 mars të çdo viti, të paraqesë raport për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar.
4. AIDA të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.
5. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KOMISIONIT TË NDIHMËS SHTETËRORE
Milva Ikononi